



**BPrAL AAB**  
INSTITUCIONI I ARSIMIT UNIVERSITAR

**Fakulteti / Departamenti:** Fakulteti i Kulturës Fizike dhe Sportit

**Lënda:** Ligjërata # Etika në lojën e tenisit

Duke iu falënderuar rregullave themelore të sjelljes në tenis, loja bëhet më e thjeshtë, më miqësore dhe interesante qoftë nëse luani në mënyrë profesionale ose rekreative. Respektimi i etikes në tenis do të ju përkujtoj se kemi të bëjmë vetëm me lojën e jo me luftën e dy personave të cilët shpalosin krenarinë dhe egon e lartë.

### **Respektimi i rregullave të sjellës me topin**

Kur njihni rregullat e kthimit të topit, më këtë bëni favor për veti dhe kundërshtarit. Nëse respektohen procedurat e kthimit të topit, ritmi i lojës nuk do të pësojë vonesa të panevojshme.

Fillestarët humbin më shumë kohë duke mbledhur topa për arsye se bëjnë më shumë gabime duke luajtur pikë të shkurta dhe duke i mos mbledhur si duhet.

Nëse i përmbaheni këtyre rregullave, më pak kohë do të shpenzoni duke e ndjekur topin:

- ✓ **Mblidhni topat të cilët përfundojnë në anën tuaj të rrjetës.** Nëse dërgoni topin në rrjetë, i vetmi veprim i duhur është që ta ktheni topin ju.
- ✓ **Nëse dërgoni topin në Mars, shkoni për ta marrë.** Nëse dërgoni topin përmbi kokën e kundërshtarit, “mbi pyll”. Mbi rrethojën, ofroni vetën për të marrë topin edhe pse teknikisht ai gjendet në pjesën ku është kundërshtari.
- ✓ **Përkujdesuni që ai i cili shërben, ti këtë dy topa pasi që mund ti duhet topi tjetër.** Nëse lojtari i cili shërben i ka dy topa, ju mund ta mbani topin tjetër. Lojtari i cili shërben gjithnjë duhet ti ketë dy topa.

### **Përcjellja e rezultatit**

Lojtari i cili shërben duhet të përcjellë rezultatit. Pas çdo pike të përfunduar, ai i cili shërben duhet ta thotë rezultatit. Tregoni rezultatit mjaft qartë, por jo edhe me zë shumë të lartë që të ju dëgjoj krejt fusha sportive. Kundërshtari mund të irritohet shumë nëse vazhdimisht e pyesni sa është rezultatit. Nëse kundërshtari flet më zë të ulet, luteni që ta ngritë zërin.

## Vendimet e ndjeshme lidhur me topat të cilët bien në vija ose përreth

Hutit dhe hamendjet më të shpeshta ndodhin kur duhet të përcaktojmë nëse topi ka rënë në fushë, ose jashtë saj (sidomos nëse nuk kemi gjyqtar që të bëjë gjykimin). Gabimet do të ndodhin gjatë lojës, është e pashmangshme. Do ti bënit që të dyja palët gjatë kallëzimit, nëse është aut.

Shpeshherë do jeni absolutisht të bindur se vendimi juaj është në rregull, e jo i kundërshtarit. Edhe nëse jeni aq i sigurt ta keni parasysh, që megjithatë mund të keni gabim. E parë sytë mund të ju tradhtojnë, sidomos kur luani me karakter garues me çka jeni plotësisht të koncentruar në lojë. E dyta, çdo lojtar konsideron se në pjesën e tij të fushës është autoritet absolut. Nëse besoni se keni humbur pikën në mënyrë të padrejtë, gëlltite këtë dhe fitoje pikën tjetër.

Për të evituar dilemat e panevojshme lidhur me aut, duhet ti keni parasysh këto gjera:

- ✓ **Menjëherë thuaje “aut”**
- ✓ **Kërkoni autin me vendosmëri**
- ✓ **Më zë të qartë dhe të prerë kërkoni autin**

## Kallëzimi i autit në lojën profesionale

Nëse arrini të përjetoni luksin që ndeshjen e tenist tua referon gjyqtari kryesor dhe ndihmësit e tij, ose ju intereson se si kjo bëhet në TV, atëherë kjo është procedura. Gjyqtari kryesor i ulur në ulësen e lartë, është figura kryesore e ndeshjes. Puna e tij është që të shkruaj rezultatin dhe të udhëheq procesin. Ai zbaton rregullat, si për shembull atë se ndërmjet pikëve nuk mund të bëni pauzë më të gjatë se 20 sekonda (shfrytëzon kohëmatësin). Nëse do paraqitet mosmarrëveshja ndërmjet lojtarëve, gjyqtarëve anësor, ose të gjitha palëve. Atëherë, gjyqtari kryesor zgjidh kontestin. Situata e vetme kur gjyqtari kryesor referon aut, kurse aty gjinden gjyqtarët anësor është vetëm në raste kur anësori bënë gabimin evident. Kjo quhet *“e drejta për të ndryshuar vendimin”*.

Nga një gjyqtar gjendet në këto shtatë pozicione kyçe:

- ✓ **Dy vija fundore:** Nga një gjyqtar qëndron tek çdo vijë fundore. I larguar nga fusha por në atë drejtim i kthyer kah vija fundore. Gjyqtari i mirë vërehet atëherë kur topi hyn në lojë ai përkulet për ti parë lëvizjet e topit me çka edhe e kryen detyrën më mirë. Gjyqtari i mirë ndihmës nuk e shikon lojën, por vijat.
- ✓ **Dy gjyqtarë anësor:** Njëri nga gjyqtar shikon vijën anësore duke qëndruar ulur, ose në këmbë në fund të fushës. Gjyqtarët gjithashtu shikojnë anën anësore të vijave të lojtarit pranues pasi që edhe ato janë pjesë e fushës. Në turne të mëdha si Grend Slem, gjyqtarët anësor janë të obliguar të shikojnë vetëm vijat e tyre anësore, prandaj vendosen edhe nga dy gjyqtarë në tjetrën anë. Megjithatë, shpeshherë vetëm një gjyqtar shikon vijën nga të dyja anët, ashtu që shikon përmes rrjetës.
- ✓ **Vija e shërbimit:** Gjyqtari këtu ndërron pozicionin e tij në fushë duke kaluar gjithnjë në anën e pranuesit. Ai qëndron në vijë të njëjtë me vijën e shërbimit.

✓ **Vija qendrore:** Një gjyqtar i cili qëndron në fund të fushës në drejtim të vijës qendrore, vëzhgon vijën qendrore gjatë shërbimit. Kur topi hyn në lojë ai shpejtë vrapon që të përkujdeset tek vija për të cilën është përgjegjës.

✓ **Gjyqtari në rrjetë:** Kjo është ëmbëlsira sa i përket punës së gjyqtarëve në tenis. Gjyqtari në rrjetë që është rri i ulur mbi rrjetë, pakëz mbi vijave fundore të dedikuara për lojën në dyshe.

### **Dy shërbime**

Kur diçka ju pengon për deri sa luani, ndaleni lojën duke thënë “po fillojmë përsëri”. Merrni dy shërbime. Nëse injoroni pengesën që iu është paraqitur, nuk kërkoni përsëritje të pikës dhe këtë arsye keni humbur pikën, lidhur me këtë ose menjëherë kërkoni dy shërbime, ose mos i kërkoni fare. Çdo lojtarë mund të kërkojë dy shërbime, pa marrë parasysh kush shërben.

Për shembull, nëse jeni në mes të lojës për pikë dhe shihni “macen e cila po e merr sandviçin me vezë” të cilin kundërshtari juaj e ka lënë në ulëse të tij, ndaleni lojën dhe thuani “Ndal! Po luajmë nga fillimi, macja ta ka vjedhur sandviçin”. Edhe nëse kundërshtari fillon të vrapojë pas maces luani dy shërbime kur të jeni të dy gati.

### **Pikët e fituara me fat përmes rrjetës të cilat kërkojnë kërkim falje**

Kërkim faljet janë shpeshherë gjeste të vogla të cilat shikuesit nuk i vërejnë, këto me së shumti bëhen kur fitoni pikën ashtu që topi e godet rrjetën, ose e goditni kundërshtarin me top. Vlen të ceket se është mbresëlënëse se shumica e lojtarëve nuk hezitojnë të kërkojnë falje edhe pse kjo nuk është e caktuar me rregulla. Kur e goditni kundërshtarin me top, vetëm thuani “Më fal nuk e pata qëllimin. A je mirë?” Nuk keni nevojë të shkoni të rrjeta dhe ti zgjasni dorën për të treguar se ju vjen keq. Mjafton një gjest i vogël.